

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d) dhe nenit 49 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e RK-së", nr.28/2008), nenit 13 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Graçanicës nr.6320/15 nga 22.10.2015, Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e shtatë të rregullt, e mbajtur më datën 29.08.2025, merr këtë:

V E N D I M Nr.46/2025/KG

për miratimin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit, e mbajtur më datën 31.07.2023

Neni 1


Miratohet procesverbali nga mbledhja e parë e jashtëzakonshme e Kuvendit Komunal, e mbajtur më datën 31.07.2025.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është procesverbali nga mbledhja e parë e jashtëzakonshme e Kuvendit Komunal, e mbajtur më datën 31.07.2025.


Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit të vendimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.



Kryesuesi i Kuvendit

Milan Dimitrijević



PROCESVERBALI

Nga mbledhja e parë e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Graçanicës

E mbajtur më datën 31.07.2025 në sallën e Kuvendit të Komunës së Graçanicës dhe filloi me punë në orën 11:00.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Millan Dimitrijeviq, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të gjithë të pranishmit dhe shtoi se në mbledhje janë të pranishëm 14 nga 19 asamblistë dhe ka kuorum, ndërsa mungojnë 5 asamblistë: Vlladica Qurçiq, Ljubisha Karaxhiq, Stefan Mitroviq dhe Granit Gashi.

Në mbledhje janë të pranishëm edhe: përfaqësuesit e KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, drejtoresha e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Shërbimi për Informim, Shërbimi për Përkthim dhe Shërbimi për Çështjet e Kuvendit.

Kryesuesi i njoftoi asamblistët se para mbledhjes së sotme të Kuvendit u mbajt mbledhja e parë e jashtëzakonshme e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe se komiteti e dha njëzëri mendimin pozitiv për rendin e ditës të caktuar për mbledhjen e sotme të Kuvendit.

Asamblisti Granit Gashi është i pranishëm në mbledhje, gjithsej janë të pranishëm 15 asamblistë dhe ka kuorum.

Kryesuesi i Kuvendit tha se në bazë të nenit 44 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 është caktuar rendi i mëposhtëm i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e gjashtë e rregullt, e mbajtur më datën 23.06.2025.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit gjashtëmuor financiar për periudhën janar – qershor 2025, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Vendimit për dhënien e pëlqimit për ndërprerjen e Aneksit III të Kontratës nr.2345/23 të datës 01.06.2023 për ofrimin e shërbimeve me kompaninë NPK “Ekologjia” Sh.A. Graçanicë, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq.
4. Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të përgjithshëm për vitin 2024 dhe Planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve.

5. Informatat për përfundimin e vitit shkollor 2024/2025, me propozim të drejtoreshës së Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Brankica Niçiq.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Komunën e Graçanicës, me propozim të kryetares së Komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq.

7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Vendimit për shfuqizimin e Vendimit nr.39/2025/KG (Nr. arkivor 2610/25 i datës 24.06.2025) për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore për parcelat 1998/2, 1999/1, 1999/2, 2007/1, 2007/2, 2008/1, 2008/3 dhe 2008/4 ZK Graçanicë, me propozim të kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Millan Dimitrijeviq.

8. Rishqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Vendimit për anulimin e Vendimit nr.2405/21 të datës 26.05.2021 (Nr.29-2021-KG) për shpalljen e parcelës nr.909-26 ZK Çagllavicë me interes të përgjithshëm publik, me propozim të kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Millan Dimitrijeviq.

9. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e gjashtë e rregullt, e mbajtur më datën 23.06.2025.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 15 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e parë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit gjashtëmujor financiar për periudhën janar – qershor 2025, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq.

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq, tha se buxheti i Komunës së Graçanicës për tremujorin e dytë të vitit 2025 është 11,039,313.35€. Për gjashtëmujorin e parë është bërë alokimi i mjeteve financiare në një shumë prej 7,121,909.92€, ndërsa janë shpenzuar 4,283,643.44€ dhe atë sipas kategorive ekonomike: Për paga dhe mëditje 2,180,102.26€, mallra dhe shërbime 600,430.52€; shpenzime komunale 138,610.98€; subvencione dhe transfere 157,054.94€ dhe për shpenzime kapitale 1,215,719.45€.

Në gjashtëmujorin e parë janë realizuar të hyrat vetanake në një shumë prej 1,465,173.68€ apo 53,68% të hyrave vetanake të planifikuara për vitin 2025 dhe të njëjtat janë alokuar në kategoritë ekonomike si në vijim

- Në mallra dhe shërbime është alokuar shuma prej 87,153.33€
- Në shërbime komunale është alokuar shuma prej 0.00€
- Në subvencione është alokuar shuma prej 35,00.00€

- Në investime kapitale është alokuar shuma prej 1,343,020.35€

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 15 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e dytë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Vendimit për dhënien e pëlqimit për ndërprerjen e Aneksit III të Kontratës nr.2345/23 të datës 01.06.2023 për ofrimin e shërbimeve me kompaninë NPK “Ekologjia” Sh.A. Graçanicë, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq.

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq, tha se nevoja e Komunës së Graçanicës për ta lidhur Aneksin III të Kontratës nr. 2345/23 të datës 01.06.2023 për ofrimin e shërbimeve me kompaninë NPK “Ekologjia” Sh.A. Graçanicë ishte e natyrës së përkohshme, për shkak të urgjencës dhe reagimit ndaj mirëmbajtjes dimërore të rrugëve. Më datën 14.07.2025, Komuna e Graçanicës ka lidhur Kontratë publike kornizë nr.2890/25 me operatorin ekonomik më të favorshëm, kështu që nevoja për vlefshmëri të mëtejshme të Aneksit III të Kontratës së lartpërmendur për ofrimin e shërbimeve pushon.

Kryesuesi paraqiti pyetjen: “ A e ka nënshkruar Komuna e Graçanicës Aneksin III të Kontratës para marrjes së Vendimit të Kuvendit të komunës?”

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq, u përgjigj se Komuna e Graçanicës fillimisht kishte shpallur tender dhe kishte marrë një vendim për operatorin ekonomik më të favorshëm, por pas ankesës, çështja shkoi në Zyrën e Prokurimit Publik dhe, kur ata e zgjidhën ankesën, e nënshkruan kontratën më datën 14.07.2025.

Kryesuesi shpjegoi se MAPL-ja vlerësoi se Vendimi për dhënien e pëlqimit për lidhjen e Aneksit III të Kontratës nuk është dashur të merret nga Kuvendi i komunës, por se një vendim i tillë duhet të merret nga kryetari i komunës. Shërbimi Ligjor Komunal propozoi që edhe ky vendim të merret nga Kuvendi, sepse në vendimin e parë, kryetari i komunës kishte dhënë pëlqimin për lidhjen e Aneksit III të Kontratës.

Asamblistja Sllagjana Rashiq, para partisë “SRPSKA”, e pyeti drejtorin nëse kishte informacion se sa i pagoi Komuna e Graçanicës NPK “Ekologjia” për pastrimin e rrugëve gjatë asaj periudhe.

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq, u përgjigj se momentalisht nuk e ka atë të dhënë, por mund ta dorëzojë më vonë.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 15 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e tretë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të përgjithshëm për vitin 2024 dhe Planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve.

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq, tha se në raportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm ka 18 rekomandime, ndërsa ai mund të flas vetëm për pjesën që i referohet Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave. Rekomandimi nr.1 ka të bëjë me të arkëtueshmet, që është mbledhja e taksave për aktivitetet e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, sepse nuk ka bazë ligjore për mbledhjen e taksave. Nga drejtori i Zhvillimit Ekonomik ka pranuar të arkëtueshmet për tre vitet e fundit, por Auditori u përgjigj se të arkëtueshmet ishin nënvlerësuar dhe se ka më shumë. Rekomandimi nr.2 i referohet keqklasifikimit të shpenzimeve, përkatësisht pagesave të bëra nga Thesari, në vend të mjeteve nga investimet kapitale, ata morën mjete nga mallrat dhe shërbimet. Rekomandimi nr.3 i referohet prezantimit jo të saktë të pasurive komunale, ku ka pasuri nën 1000 euro dhe mbi 1000 euro, ku dy zyrtarë i kanë futur gabimisht të dhënat. Rekomandimi nr.4 i referohet nënvlerësimit të detyrimeve kontingjente në RVF, përkatësisht një çështje gjyqësore për të cilën avokati publik i komunës i ka dhënë të dhënat e pasakta. Rekomandimi nr.5 i referohet realizimit të sasive të kontratës me çmim për njësi. Kjo i takon Shërbimit të Prokurimit Publik dhe për këtë rekomandimin nuk kam shpjegim. Rekomandimi nr.6 i referohet përdorimit joadekuat të kontratave publike komunale dhe kjo bie nën Shërbimin e Prokurimit Publik. Rekomandimi nr.7 i referohet mosrespektimit të hapave për procedimin e pagesave sipas kërkesës së Rregullës. Kjo përsëri i bie nën Shërbimin e Prokurimit Publik. Rekomandimi nr.8 i referohet mungesës së raporteve për vijueshmërinë në punë. Rekomandimi nr.9 i referohet mosharmonizimit të kontratave të punës/akt emërimeve sipas kërkesave ligjore.

Drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Brankica Niçiq, se rekomandimi nr.9 vlen për punonjësit e arsimit dhe shëndetësisë që me kontratë kanë një vend pune, por për shkak të situatës specifike, këta punonjës nuk mund të punojnë në shkollë, por punojnë në Komunën e Graçanicës.

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq, vazhdoi me shpjegime: Rekomandimi nr.10 i referohet sistemimit të stafit të Sektorit të Arsimit dhe të Shëndetësisë jo në përputhje me kontratat e punës.

Rekomandimi nr.11 i referohet aplikimit të koeficientit jo në pajtueshmëri me Ligjin për paga.

Rekomandimi nr.12 i referohet mangësisë në bazën e të dhënave të tatimpaguesve në pronë, përkatësisht taksapaguesve që nuk kishin numër të letërnjoftimi dhe kjo vlen për lëndët që i trashëguam nga komunat mëmë: Prishtina, Fushë Kosova dhe Lipjani.

Rekomandimi nr.13 i referohet mungesës së dëshmive për llogaritë e arkëtueshme nga taksa për ushtrimin e veprimtarisë.

Rekomandimi nr.14 i referohet vonesave në pagesën e detyrimeve të papaguara në PVF. Afati ligjor për pagesën e faturës është 30 ditë, ndërsa pas 30 ditësh ne jemi të detyruar ta raportojmë atë faturë, megjithatë, nuk kemi raportuar asnjë faturë në kohë.

Rekomandimi nr.15 i referohet menaxhimit të kontratave jo përmes platformës së prokurimit.

Rekomandimi nr.16 i referohet mosrespektimit të afatit ligjor për pranimin e tenderëve.

Rekomandimi nr.17 i referohet mungesës së realizimit të inventarizimit të pasurisë jofinanciare. Është e nevojshme të regjistrohet pasuria jo-financiare e komunës.

Rekomandimi nr.18 i referohet mangësisë në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme.

Kryesuesi pyeti a po përsëriten rekomandimet nga vitet e kaluara.

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq, u përgjigj se ato përsëriten kryesisht. Raporti i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm thotë se nuk ka pasur shkelje materiale, gjë që është mirë për komunën, si dhe se këto janë të gjitha çështje teknike që duhet të zgjidhen hap pas hapi.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Informatat për përfundimin e vitit shkollor 2024/2025, me propozim të drejtoreshës së Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Brankica Niçiq.

Drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Brankica Niçiq, njoftoi se gjysmëvjetori i dytë në shkollat ku mësimi zhvillohet në gjuhën serbe përfundoi më 13.06.2025 për nxënësit e shkollës fillore ose më 20.06.2025 për nxënësit e shkollës së mesme. Shkollat ku mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe përfundoi më 23.06.2025 për nxënësit e klasave 1-8 ose më 05.06.2025 për nxënësit e klasave 9-11. Për shkak të provimeve përfundimtare, mësimi përfundoi pak më herët për nxënësit e klasave përfundimtare. Mësimet u zhvilluan me sukses, pa vështirësi të mëdha dhe sipas kurrikulës dhe programit të përcaktuar më parë.

Asamblisti Dragan Maksimović, para partisë "SRPSKA", e vlerësoi punën e drejtoreshes dhe drejtorisë së saj, duke thënë se Drejtoria e Arsimit përpiqet gjithmonë ta përmbushë çdo kërkesë të bërë nga shkollat, në përputhje me mundësitë e saj.

Asamblistja Snezhana Jovanović, para partisë "SRPSKA", pyeti nëse mund të gjendej një zgjidhje për ta bërë më të lehtë për komunën t'u sigurojë fëmijëve transport për aktivitete të caktuara kulturore, sepse ata duhet të paguajnë për karburant dhe një pagesë ditore për vozitësin.

Drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Brankica Niçiq, u përgjigj se kanë një buxhet vjetor prej 30,000 eurosh vetëm në emër të arsimit. Deri para 3 vitesh, komuna siguronte një vozitës dhe karburant sipas kërkesës, por sipas ligjit të ri, zyrtarët komunalë mund të marrin një pagesë ditore vetëm nëse komuna merr një kërkesë zyrtare.

Asamblistja Snezhana Jovanović, para partisë "SRPSKA", propozoi gjetjen e një mënyre për ta zgjidhur këtë problem, për shembull duke lidhur një marrëveshje për bashkëpunim të përbashkët me disa organizata joqeveritare dhe duke e mbuluar atë ligjërisht.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Komunën e Graçanicës, me propozim të kryetares së Komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq.

Anëtar i Grupit punues për hartimin e Propozimit të Rregullores, Aleksandar Todorović, tha se me autorizimin e kryetares së Komunës së Graçanicës do të shpjegojë Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Komunën e Graçanicës. Me Propozimin e Rregullores rregullohet organizimi i brendshëm brenda Komunës së Graçanicës, krijohen njësitë e brendshme organizative dhe kompetencat e tyre, grupohen vendet e punës sipas kategorisë, nivelit, kualifikimit dhe natyrës së punës dhe përcaktohet zbatimi i Rregullores për

njësitet organizative dhe punonjësit në përputhje me ligjet në fuqi. Konkretisht, aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të përmendura janë: Ligji nr.08/L-197 për zyrtarët publik, Ligji nr.08/L-196 për pagat në sektorin publik, Rregullorja nr.06/2024 për klasifikimin e vendeve të punës dhe Katalogu i vendeve të punës në shërbimin civil, si dhe Statuti i Komunës së Graçanicës dhe aktet ligjore dhe nënligjore nga fusha të tjera relevante që u morën gjithashtu në konsideratë. Duke u nisur nga rregullorja e mëparshme, me secilin udhëheqës të drejtpërdrejtë u diskutuan strukturat individuale organizative, misionet, numri i punonjësve, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë dhe vetë struktura e secilës drejtori dhe njësie më të ngushta organizative. Përveç këtij procesi, është zbatuar edhe procesi i klasifikimit të vendeve të punës në shërbimin civil, i cili përmbahet në vetë Propozimin e Rregullores. Duke u bazuar në Rregulloren për klasifikimin dhe Katalogun e vendeve të punës, për të gjitha pozitat u përcaktua një kategori, klasë dhe grup të cilit i përket secila pozitë. Duke u bazuar në mendimin e Departamentit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), Rregullorja e lartpërmendur përmban gjithashtu klasifikimet dhe strukturat organizative të institucioneve në fushat e arsimit, shëndetësisë, mirëqenies sociale dhe familjare, si dhe institucioneve kulturore që janë nën juridiksionin e Komunës së Graçanicës. Strukturat dhe klasifikimet e mësipërme organizative u morën nga Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës dhe Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe si të tilla janë të përfshira në Propozimin e Rregullores. Qëllimi i hartimit të Rregullores dhe zbatimit të procesit të klasifikimit është harmonizimi i strukturës organizative të Komunës së Graçanicës me aktet ligjore dhe nënligjore dhe krijimi i një sistemi të organizuar që do të kontribuonte në funksionimin efikas të qeverisjes lokale. Pas hartimit, Propozimi i Rregullores iu dërgua Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme për mendim. Pas dy ndryshimeve, Propozimi i Rregullores kaloi nëpër procesin të konsultimit publik. Gjatë procesit të konsultimit publik dhe pas takimit publik, u pranua një propozim që u refuzua. Me Statutin e Komunës së Graçanicës është përcaktuar struktura organizative e Komunës së Graçanicës. Komuna e Graçanicës, përveç organeve të Kuvendit të komunës dhe kryetarit (Kabinetit të kryetarit), përbëhet edhe nga 11 drejtori. Propozimi i Rregullores përmban emra e të gjitha njësiteve organizative, misionin, detyrat dhe përgjegjësitë, linjat e raportimit dhe numrin e punonjësve në njësitë organizative. Gjatë përgatitjes së Propozimit të Rregullores për organizimin e brendshëm të vendeve të punës në Komunën e Graçanicës, u konsultuan të gjithë palët e interesuara përkatëse për të cilat zbatohet ky Propozim. Me përfundimin e procesit të konsultimit publik janë përmbushur kushtet për t'ia paraqitur propozimin e lartpërmendur Kuvendit Komunal për shqyrtim.

Asamblistja Snezhana Jovanović, para partisë “SRPSKA”, pyeti cilat janë ndryshimet kryesore.

Anëtar i Grupit punues për hartimin e Propozimit të Rregullores, Aleksandar Todorović, u përgjigj se në thelb nuk ka ndryshime të rëndësishme dhe ai vuri re organogramin e bashkangjitur të rregullores, ku në kolonën e parë poshtë kryetarit të komunës gjendet Sektori i Çështjeve Ligjore dhe Sektori i Prokurimit Publik, në përputhje me rekomandimet që u morën nga departamenti, si dhe në përputhje me Rregulloren për klasifikimin e vendeve të punës, këto pozita janë pozita që raportojnë drejtpërdrejt te kryetari i komunës, kështu që kjo rregullore është në përputhje me atë strukturë.

Asamblistja Snezhana Jovanoviq, para partisë “SRPSKA”, pyeti a ka mundësi për ndryshimin e numrit të vendeve të punës.

Anëtar i Grupit punues për hartimin e Propozimit të Rregullores, Aleksandar Todoroviq, u përgjigj se numri i ekzekutorëve është përcaktuar nga të dy grupet e punës në bashkëpunim me të gjithë drejtuesit e drejtorive. Kjo nuk do të thotë që numri aktual i vendeve të punës është plotësuar, ndërsa numri i ekzekutorëve pasqyron nevojat e drejtorive dhe shërbimeve komunale, si dhe se ai do të plotësohet në një periudhë të ardhshme në përputhje me disponueshmërinë e mjeteve buxhetore.

Asamblistja Sllagjana Rashiq, para partisë “SRPSKA”, pyeti pse është punuar tani për këtë rregullore dhe a ka ndryshuar ndonjë gjë në ligj.

Anëtar i Grupit punues për hartimin e Propozimit të Rregullores, Aleksandar Todoroviq, u përgjigj se është detyrim për harmonizimin e kësaj rregulloreje me aktet e listuara më herët nga ai, ndërsa dy rekomandimet e dhëna nga Auditimi i jashtëm ndërliken me harmonizimin e rregullores, si dhe se miratimi i kësaj rregulloreje është parakusht për zbatimin e këtyre rekomandimeve.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 15 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e gjashtë të rendit të ditës.

Në mbledhje mungon asamblisti Granit Gashi, gjithsej janë të pranishëm 14 asamblistë dhe ka kuorum.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Vendimit për shfuqizimin e Vendimit nr.39/2025/KG (Nr. arkivor 2610/25 i datës 24.06.2025) për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore për parcelat 1998/2, 1999/1, 1999/2, 2007/1, 2007/2, 2008/1, 2008/3 dhe 2008/4 ZK Graçanicë, me propozim të kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Millan Dimitrijeviq.

Kryesuesi shpjegoi se në mbledhjen e mëparshme ata kishin marrë vendim për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore për parcelat në pronësi të Manastirit të Graçanicës dhe për realizimin e projektit për ndërtimin e objekteve montuese të destinuara për nevojat e Kuzhinës sociale. Pas shqyrtimit, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural vlerësoi se akti komunal është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe se nuk është në përputhje me nenin 11 paragrafët 2 dhe 4 dhe nenin 44 paragrafi 1 të Ligjit nr.02/L-26 për Tokën Bujqësore. Neni 11 paragrafi 2 thotë se “Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore mund të bëhet vetëm në pajtim me planin e rregullimit hapësinor dhe dispozitat tjera të përcaktuara me Ligj”. Megjithatë, Komuna e Graçanicës ia dërgoi planin e përgjithshëm urban asaj ministrie për miratim në vitin 2014 dhe kërkoi që ai të ndryshohej, por deri më tani ata nuk kanë marrë asnjë vendim dhe se ministria ka qenë pengesa kryesore për zhvillimin e komunës për tre vitet e fundit.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 14 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e shtatë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Rishqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Vendimit për anulimin e Vendimit nr.2405/21 të datës 26.05.2021 (Nr.29-2021-KG) për shpalljen e parcelës nr.909-26 ZK Çagllavicë me interes të përgjithshëm publik, me propozim të kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Millan Dimitrijeviq.

Kryesuesi shpjegoi se në mbledhjen e mëparshme të rregullt ata e miratuan Vendimin për anulimin e Vendimit nr.2405/21 të datës 26.05.2021 (Nr.29-2021-KG) për shpalljen e parcelës nr.909-26 ZK Çagllavicë me interes të përgjithshëm publik. Megjithatë, MAPL-ja kërkoi që vendimi të rishqyrtohet sepse nuk ishin përmbushur disa çështje ligjore procedurale, se ata e morën materialin për plotësimin e rendit të ditës tre ditë para mbledhjes si dhe se vendimit i mungon “Arsyetimi” edhe pse ata nuk e kanë kërkuar kurrë deri më tani këtë.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 14 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e tetë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Të ndryshme.

Asamblistja Snezhana Jovanoviç, para partisë “SRPSKA”, ua rikujtoi asamblistëve se katër vjet më parë u formua Komisioni për shqyrtimin e kërkesave të banorëve për ndarjen e tokës komunale, mbi të cilën ata kishin ndërtuar shtëpi 30 ose më shumë vjet më parë dhe në të cilën jetojnë. Kuvendi i komunës mori një vendim në atë kohë, por ky vendim është dashur të refuzohet sepse zgjedhjet lokale ishin shpallur në të njëjtën ditë dhe Kuvendi i komunës ishte në një mandat teknik. Në një takim me kryetaren e komunës është propozuar të riformohet ai komision dhe se anëtarët e Kuvendit të mëparshëm ishin gjithashtu në atë komision.

Kryesuesi u përgjigj se ky Kuvendi është aktualisht në një mandat teknik, prandaj propozoi që kryetarja e komunës ta formojë atë komision, që komisioni t’i rishqyrtojë kërkesat si dhe që Kuvendi i ardhshëm ta votojë këtë vendim. Kryesuesi sugjeroi konsultimin me Shërbimin Ligjor për të parë nëse asamblistët janë të detyruar të jenë në atë komision.

Pasi që askush nuk e mori fjalën për të diskutuar lidhur me pikën “Të ndryshme” të rendit të ditës, kryesuesi falënderoi për bashkëpunim dhe mbledhja mbaroi në orën 11:55.

Procesmbajtësi
Agron Karadollami

